

MENAXHIMI

i afateve dhe vazhdimësia strategjike:

Rishikim i procesit të miratimit të Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (2026-2030)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕГУНАРОДНА
СОРАБОТКА

МЦМС

Titulli: Menaxhimi i afateve dhe vazhdimësia strategjike: Rishikim i procesit të miratimit të Strategjisë së re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (2026-2030)

Botues: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS)

Autorë: Snezhana Kamillovska Trpovska dhe Lejla Tutiq (MCMS)

Përkthim nga maqedonishtja në shqip: Gramoz Shabani

Dizajni: Kontura DOO Shkup

Shkup, korrik 2026

Ky botim është financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e autorëve Snezhana Kamillovska Trpovska dhe Lejla Tutiq dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i çdo pjese të këtij botimi mund të bëhet vetëm me lejen paraprake të botuesve, për qëllime citimi në një recension libri dhe sipas kushteve të përcaktuara më poshtë.

Ky botim është i mbrojtur nga të drejtat e autorit, por mund të riprodhohet në çdo formë pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjim në kushte të tjera, për përdorim në botime të tjera ose për përkthim ose përshtatje, duhet të merret leje paraprake nga botuesit.

Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Analiza e procesit të përgatitjes dhe zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (2026-2030)	6
3. Gjetjet kryesore nga procesi i zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (2026-2030)	11
3.1. Avantazhet e procesit.....	11
3.2. Dobësitë e sistemit dhe dështimet e procesit.....	12
4. Rekomandime për veprim	14
4.1. Për Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	14
4.2. Për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK)	14
4.3. Udhëzime për veprimin e organizatave të shoqërisë civile	15

1. Hyrje

Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbetet sfida më serioze shoqërore që e dëmton drejtpërdrejt zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit dhe funksionalitetin e institucioneve. Se lufta kundër korrupsionit deri më tani ka dhënë efekte të moderuara dhe të pakënaqshme, tregohet qartë nga të dhënat nga Raporti i vlerësimit të korrupsionit për Maqedoninë e Veriut për vitin 2025.¹ Ky raport vëren një trend alarmues sipas të cilit presioni i korrupsionit mbi qytetarët po rritet me shpejtësi, ndërsa efikasiteti i sistemit gjyqësor në përpunimin e rasteve të tilla është në një nivel kritikisht të ulët. Të njëjtat të dhëna tregojnë se perceptimi publik për përhapjen e korrupsionit midis politikanëve, gjyqtarëve dhe nëpunësve publikë po thyen rekorde negative, gjë që krijon një ndjenjë të thellë midis qytetarëve se korrupsioni është bërë i pandëshkuar dhe reformat institucionale kanë mbetur vetëm në nivelin e retorikës deklarative politike.

Në një mjedis të tillë destruktiv, planifikimi strategjik nuk është luks, por një mekanizëm urgjent për mbijetesën e të gjithë sistemit institucional. Strategjitë kombëtare janë instrumenti kryesor shoqëror që duhet të krijojë koordinim të fortë ndërinstitutional në parandalimin e këtij fenomeni. Shtylla kryesore në këtë proces është Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), i cili e merr kompetencën e tij të drejtpërdrejtë dhe detyrimin ligjor nga neni 18 i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit². Kjo dispozitë ligjore përcakton qartë se KSHPK është ekskluzivisht kompetent për të përgatitur Strategjinë Kombëtare pesëvjeçare dhe planet përkatëse të veprimit. Ligji gjithashtu e detyron KSHPK-në të udhëheqë këtë proces përmes konsultimeve të gjera dhe gjithëpërfshirëse me organet e qeverisjes shtetërore, vetëqeverisjen lokale, shoqërinë civile dhe median, pas së cilës është e detyruar t'ia paraqesë dokumentin përfundimtar Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim. Me këtë, Parlamenti merr rolin e filtrit përfundimtar, i cili, duke miratuar strategjinë, duhet t'i japë asaj legjitimitet të plotë shtetëror dhe politik.

Megjithatë, praktika aktuale në terren tregon një ndërprerje serioze institucionale. Strategjia e re Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit për periudhën 2026–2030 aktualisht po përballet me një vonesë sistemike prej saktësisht gjashtë muajsh. Sipas kornizës fillestare, dokumenti duhej të finalizohet dhe të miratohet më së voni deri në fund të dhjetorit 2025, në mënyrë që zbatimi i tij të mund të fillonte menjëherë në janar 2026, duke siguruar kështu vazhdimësinë e Strategjisë së mëparshme dhe të re. Pas një procesi të gjatë dhe kompleks harmonizimi, KSHPK-ja më në fund e miratoi Strategjinë në seancën e saj të mbajtur më 19 qershor 2026. Megjithatë, në kohën e përgatitjes së këtij dokumenti politikash, procesi është përsëri në një ngërç të paqartë dhe të dëmshëm, sepse Parlamenti ende nuk e ka paraqitur këtë Strategji për shqyrtim në organin mëmë parlamentar, pra para Komisionit për Sistemin Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, që do të thotë se institucionet kanë vepruar në një lloj vakumi strategjik për gjysmë viti.

1 Raporti mbi vlerësimin e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut, 2025, i disponueshëm në linkun e mëposhtëm: https://mcms.mk/images/docs/2025/mcms_nacionalen_izvestaj_2025.pdf

2 Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, Gazeta zyrtare Nr. 12/2019, i disponueshëm në: <https://shorturl.at/bUoNO>

Kjo shkelje e afateve ligjore nuk është një incident i izoluar, por një përsëritje kronike e praktikave të dobëta ndërinstitucionale. Strategjia Kombëtare e mëparshme u miratua gjithashtu me një vit të plotë vonesë, kështu që në vend që të mbulonte kornizën e parashikuar 2020–2024, për shkak të pengesave parlamentare dhe inercisë administrative, ajo u transformua për periudhën 2021–2025. Suksesi dhe efektet e asaj strategjie të mëparshme janë treguesi më i mirë i pasojave shkatërruese të vonesave të tilla. Sipas Raportit përfundimtar mbi zbatimin e saj, të miratuar nga KSHPK në mars 2026, bilanci përfundimtar i zbatimit të aktiviteteve të planifikuara është dëshpërues dhe tregon se vetëm 37% e aktiviteteve të parashikuara u zbatuan plotësisht gjatë pesë viteve. Shumica e masave kryesore në sektorët kritikë mbetën të parealizuara ose të bllokuara në një status ekzekutimi të përhershëm. Kjo sugjeron se është pikërisht ofrimi i dobët i institucioneve që duhej të zbatonin masat dhe mungesa totale e vullnetit politik midis ligjvënësit për të mbikëqyrur dhe ushtruar presion mbi procesin që ndikon drejtpërdrejt në këto rezultate të dobëta.

Qëllimi i këtij dokumenti të politikave publike është të hartëzojë në mënyrë faktike procesin e përgatitjes së Strategjisë së re Kombëtare 2026-2030, të dokumentojë në detaje rrjedhën kronologjike dhe të gjejë pengesat sistemike në këto gjashtë muaj vonesë. Përmes kësaj analize faktike, dokumenti dëshiron t'i dërgojë një apel të qartë Parlamentit që ta vendosë urgjentisht dokumentin në procedurën parlamentare dhe të ofrojë rekomandime specifike për të parandaluar që politikat kryesore strategjike antikorruption të mbahen peng të heshtjes institucionale në të ardhmen.

2. Analiza e procesit të përgatitjes dhe zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (2026-2030)

Procesi i zhvillimit të Strategjisë Kombëtare u karakterizua nga një strukturë metodologjike komplekse dhe një sërë hapash konsultativë, dinamika kohore e të cilave tregon në mënyrë indirekte sfidat institucionale në menaxhimin e afateve.

Fillimi zyrtar u shënuar më 28 shkurt 2025, kur u mbajt punëtorja fillestare, e cila u përqendrua në vlerësimin e ciklit të mëparshëm (2021-2025) dhe përcaktimin e një udhërrëfyese konkret për strategjinë e re³. Diskutimet kryesore u zhvilluan rreth nevojës për të rishikuar treguesit e performancës, pasi praktika e mëparshme ka treguar se institucionet shpesh paraqesin raporte formale, por në thelb boshe të zbatimit. Takimi theksoi se strategjia e re duhet të bazohet në një vlerësim realist të dobësive dhe se afatet për koordinim me ministritë duhet të përcaktohen në mënyrë strikte në mënyrë që të shmanget një periudhë e ndërmjetme pa një dokument strategjik. Në punëtori morën pjesë përfaqësues të organeve shtetërore dhe institucioneve të përfshira në zbatimin e Strategjisë Kombëtare, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në vend, si dhe të shoqërisë civile dhe sektorit privat.

Për të mundësuar këtë qasje shkencore, KSHKP-ja e miratoi zyrtarisht Metodologjinë e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit në maj 2025.⁴ Ky akt specifik ligjor dhe teknik ishte thelbësor sepse synon të përcaktojë kriteret cilësore dhe sasiore kundrejt të cilave do të matet gjasa dhe ndikimi i korrupsionit.

3 Njoftim publik i publikuar nga KSHKP, i disponueshëm në: <https://shorturl.at/Sfx5G>

4 Metodologjia për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit për qëllime të zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, maj 2025, e disponueshme në: <https://shorturl.at/XsbnN>

Puna intensive në terren filloi në qershor 2025 përmes organizimit të grupeve kombëtare të fokusit. U zhvilluan katër grupe fokusi për të vlerësuar rreziqet e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe u mbajtën më 4 dhe 5 qershor 2025, ku morën pjesë përfaqësues nga institucionet qendrore të qeverisë, organet e pavarura, NP dhe SHA, së bashku me përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe sektori i shoqërisë civile⁵. Të gjithë pjesëmarrësve në punëtori iu dha një grup i strukturuar pyetjesh për grupet e fokusit, i cili do të shërbente si një mjet për konsultim dhe koordinim paraprak brenda organizatave, me qëllim pjesëmarrjen aktive dhe cilësore në procesin e përgatitjes së Strategjisë së re.

Procesi vazhdoi në shtator 2025 me një takim pune të fokusuar midis KSHPK-së dhe Platformës së organizatave të shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit⁶. Në këtë takim, sektori i shoqërisë civile dha një kontribut të konsiderueshëm jo duke shtuar masa të reja, por duke dhënë propozime konkrete për optimizimin strategjik të dokumentit. Platforma këmbënguli që strategjia e ardhshme të jetë koncize, dukshëm më e shkurtër dhe pa barrë të panevojshme administrative, me qëllim që të sigurohet zbatimimi i saj real dhe i matshëm në terren dhe të parandalohet përsëritja e joefikasitetit të së kaluarës.

Vjeshta e vitit 2025 solli një konsolidim kyç institucional. Në tetor 2025, KSHPK e miratoi metodologjinë e dytë në këtë proces - Metodologjinë për zhvillimin e vetë Strategjisë Kombëtare⁷, e cila përcaktoi strukturën, mënyrën e përcaktimit të qëllimeve strategjike dhe mekanizmat për monitorimin e ardhshëm të planeve të veprimit. Paralelisht me këtë, në të njëjtin muaj, duke përdorur gjetjet e grupeve të fokusit të qershorit, KSHPK e finalizoi Vlerësimin zyrtar të rrezikut të korrupsionit⁸, i cili shërbeu si bazë faktike për përcaktimin e prioriteteve sektoriale. Tashmë në këtë pikë, vonesat e para në proces u bënë të dukshme sepse në vend që të përcaktonte masat dhe aktivitetet në fund të tetorit, KSHPK ishte ende në fazën e konsolidimit të dokumenteve bazë për bashkë-haritim të vetë Strategjisë së ardhshme.

Devijimi nga dinamika e planifikuar fillimisht u bë i dukshëm në nëntor dhe dhjetor 2025, kur u organizuan punëtori tematike për shkrimin e masave dhe aktiviteteve specifike kundër korrupsionit sipas fushave dhe sektorëve, si dhe institucioneve kompetente për zbatimin e tyre. Gjatë këtyre dy muajve, nga KSHPK u organizuan gjithsej 14 punëtori tematike, që do të thotë dy punëtori për secilën fushë, pra sektor. Brenda fushave horizontale, u mbajtën punëtori mbi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit më 19.11.2025 dhe 18.12.2025, ndërsa punëtori të dedikuara për prokurimin publik u mbajtën më 24.11.2025 dhe 02.12.2025. Paralelisht me to, u organizuan edhe punëtori sektoriale. Kështu, për urbanizmin dhe planifikimin hapësinor u mbajtën më 28.11.2025 dhe 22.12.2025, për objektet e transportit dhe infrastrukturës më 06.11. 2025 dhe 24.12.2025, për drejtësi më 14.11.2025 dhe 28.11.2025, për shëndetësi më 01.12.2025 dhe 12.12.2025, dhe për mjedis,

5 Njoftim publik i publikuar nga KSHPK, i disponueshëm në: <https://shorturl.at/rT6Qk>

6 Njoftim publik i lëshuar nga KSHPK-ja, në dispozicion në: <https://shorturl.at/OKAX2>

7 Metodologjia për përgatitjen e një strategjie kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2026-2030, e disponueshme në: https://dksk.mk/wp-content/uploads/2025/11/10-1551-266_ocred.pdf

8 Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit për qëllime të zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2026-2030, i disponueshëm në: https://dksk.mk/wp-content/uploads/2025/11/10-1551-265_ocred.pdf

energji dhe burime natyrore më 11.12.2025 dhe 27.11.2025. Përfaqësues të organeve shtetërore, institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat u ftuan dhe morën pjesë në këto punëtori nga KSHPK. Prandaj, mund të konkludohet me të drejtë se është bërë një përpjekje serioze për të siguruar pjesëmarrjen e një rrethi të gjerë dhe të larmishëm të palëve të interesuara, në mënyrë që ato të kontribuojnë në këtë proces. Me fjalë të tjera, mund të vlerësohet se KSHPK po krijon një praktikë të re dhe pozitive të krijimit gjithëpërfshirës të dokumenteve strategjike, duke bërë kështu një hap të rëndësishëm përpara krahasuar me proceset e mëparshme, në të cilat nuk është aplikuar një qasje e tillë.

Fakti që harmonizimi i tekstit me ministrinë dhe institucionet e ndryshme ishte ende në vazhdim gjatë gjithë dhjetorit sugjeron që afati kohor institucional nuk ishte planifikuar mjaftueshëm në mënyrë proaktive, duke pasur parasysh se ai muaj ishte afati i fundit deri në të cilin Parlamenti duhet ta kishte miratuar dokumentin.

Boshllëku më i madh administrativ hapet në gjysmën e parë të vitit 2026. Pas pothuajse tre muajsh heshtjeje, më 9 prill 2026, KSHPK u dërgon një e-mail të gjithë palëve të interesuara të përfshira në zhvillimin e Strategjisë me një kërkesë për një opinion mbi të me një afat kohor për dorëzimin e tyre jo më vonë se 24 prilli. Qëllimi i kësaj faze të ndërmjetme është që të gjitha institucionet dhe palët e tjera të interesuara që janë përcaktuar si bartës të një aktiviteti ose subjekte të përfshira në një fushë ose sektor të caktuar përmes aktiviteteve specifike të shprehin mendimin e tyre mbi to. Përveç kësaj, KSHPK kërkon që institucionet kompetente të shprehin gjithashtu mendimin e tyre mbi implikimet financiare të çdo aktiviteti ku ato janë bartës. Megjithatë ky komunikim me e-mail iu dërgua një numri të madh palësh të interesuara, KSHPK nuk u dërgoi në asnjë moment atyre që paraqitën një opinion specifik një përgjigje nëse pikëpamjet dhe kërkesat e tyre u pranuan apo u refuzuan dhe një shpjegim për vendimin. Iu la vlerësimit të pavarur të palëve të interesuara të bënte krahasime të versionit të punës me atë të miratuar nga KSHPK.

Faza e fundit e konsultimeve pasoi kur KSHPK hapi procesin zyrtar të konsultimit publik më 27 maj 2026. Sipas njoftimit për shtyp të lëshuar⁹ nga KSHPK, palët e interesuara dhe qytetarët patën mundësinë të paraqisnin komentet e tyre mbi draftin e Strategjisë deri më 8 qershor 2026, që do të thotë se i gjithë procesi i konsultimit zgjati gjithsej 13 ditë. Vetë njoftimi për shtyp, ndër të tjera, thekson se megjithatë u aplikua një qasje pjesëmarrëse në përgatitjen e masave dhe aktiviteteve me pjesëmarrjen aktive të të gjithë palëve të interesuara shoqërore përkatëse, KSHPK beson se para miratimit të Strategjisë Kombëtare, është e nevojshme që ajo të bëhet publike dhe e disponueshme për komente nga publiku i gjerë. Një angazhim i tillë nga KSHPK paraqet një shembull pozitiv të sigurimit të përfshirjes, veçanërisht në procese me rëndësi të jashtëzakonshme siç është përgatitja e dokumenteve strategjike në fushën e antikorrupsionit. Megjithatë, ajo që pasoi pas publikimit të kësaj deklarate sugjeron se ky angazhim mbeti vetëm deklarativ, pasi procesi nuk u përfundua në një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, duke pasur parasysh se rezultatet e konsultimeve publike nuk u publikuan.

9 Njoftim publik i publikuar nga KSHPK-ja, i disponueshëm në: <https://dksk.mk/mk/%d0%bd%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%be%d0%bd%d0%b0%d0%bb%d0%bd%d0%b0-%d1%81%d1%82%d1%80%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%b3%d0%b8%d1%98%d0%b0-2026-2030/>

Konkretisht, pas përfundimit të konsultimeve, nuk u publikua asnjë raport mbi rezultatin e tyre, d.m.th. publiku nuk pati informacion se çfarë komentesh, propozimesh dhe vëzhgimesh u paraqitën nga palët e interesuara dhe qytetarët, cilat prej tyre u pranuan, cilat u refuzuan, as nuk u dha një shpjegim për arsyet pse propozime të caktuara nuk u morën parasysh. Në vend të kësaj, u publikua vetëm versioni përfundimtar i Strategjisë Kombëtare, i cili më pas u miratua nga KSHPK-ja.

Mungesa e një raporti të tillë i kufizon njohuritë e publikut mbi mënyrën se si u morën në konsideratë mendimet e paraqitura dhe zvogëlon mundësinë e vlerësimit nëse procesi konsultativ pati një ndikim të konsiderueshëm në përmbajtjen përfundimtare të Strategjisë. Publikimi i dokumentit përfundimtar, pa dhënë njëkohësisht informacion mbi rrjedhën dhe rezultatet e konsultimeve publike, lë përshtypjen se pjesëmarrja e publikut u kuptua më shumë si një detyrim formal sesa si një mekanizëm për përmirësimin thelbësor të dokumentit. Një praktikë e tillë nuk është në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes që duhet të udhëheqin proceset e përgatitjes dhe miratimit të politikave publike.

Ky boshllëk prej gati gjashtë muajsh tregon në mënyrë indirekte një ngërç të caktuar institucional të brendshëm në fazën e finalizimit dhe konsolidimit teknik të tekstit brenda Komisionit. Pas përfundimit të konsultimeve, KSHPK-ja e miratoi zyrtarisht Strategjinë Kombëtare në seancën e saj më 19 qershor 2026 dhe e paraqiti zyrtarisht atë në Parlament në të njëjtën ditë. Kjo do të thotë që procesi i përgjithshëm përgatitor zgjati plot 16 muaj, i cili, megjithëse lejoi një strukturë të detajuar, përsëri rezultoi në kalimin e topit të ligjvënësi me një vonesë tashmë të akumuluar prej gjashtë muajsh në nivel kombëtar.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet praktika pozitive e KSHPK-së në aspektin e publikimit proaktiv të materialeve përgatitore në ueb faqen e saj zyrtare. Komisioni siguroi akses të lartë digjital të dokumenteve, duke ngarkuar me kujdes propozim-aktet dhe thirrjet gjatë gjithë fazave kryesore, që nga hapat fillestarë në vitin 2025, përmes punëtorive sektoriale në nëntor/dhjetor, deri në thirrjen zyrtare për konsultime publike në maj 2026. Megjithatë, kjo hapje digjitale në botimin e teksteve mbeti në sferën e informacionit publik një kahesh, duke pasur parasysh se mungonte informacioni mbi procesin e harmonizimit të brendshëm, si dhe një mekanizëm thelbësor reagimi mbi rezultatin e komenteve të paraqitura pas përfundimit të konsultimit publik.

Tabela 1: Përmbledhje kronologjike e fazave në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare (2025-2026)

Data / Periudha	Ngjarja/Faza kryesore në proces	Konteksti dhe statusi analitik
28 shkurt 2025	Punëtori hyrës dhe udhërrëfyes	Korniza fillestare për periudhën 2026-2030 është përcaktuar duke theksuar nevojën për tregues të performancës me cilësi më të lartë dhe realistë.
Maj 2025	Miratimi i metodologjisë së parë	KSHPK-ja e miraton zyrtarisht <i>Metodologjinë e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit</i> , duke vendosur kriteret për matjen e dobësive sistemike.
Qershor 2025	Grupet kombëtare të fokusit	Po mbahen katër fokus grupe për të vlerësuar rreziqet e korrupsionit në vend.
Shtator 2025	Konsultimet me sektorin civil	Takim pune me Platformën e organizatave të shoqërisë civile; paraqiten propozime që strategjia të jetë koncize, më e shkurtër dhe realiste e zbatueshme në terren.
Tetor 2025	Miratimi i metodologjisë së dytë	KSHPK e miraton <i>Metodologjinë për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare</i> , duke e përcaktuar strukturën dhe mënyrën e monitorimit të planeve të veprimit.
Tetor 2025	Finalizimi i vlerësimit të rrezikut	Është zhvilluar <i>Vlerësimi zyrtar i rrezikut të korrupsionit</i> , i cili shërben si bazë faktike dhe empirike për prioritetet sektoriale.
Nëntor – Dhjetor 2025	Punëtori tematike sipas fushave dhe sektorëve	Punëtoritë e fundit sektoriale për shkrimin e masave po mbahen në momentin kur afati për miratimin e dokumentit tashmë po skadon.
Janar – Prill 2026	Boshllëk institucional	Një periudhë prej gati katër muajsh konsolidimi të brendshëm teknik të tekstit brenda KSHPK-së, ndërkohë që shteti tashmë po hyn në një vakum strategjik pa një strategji të vlefshme.
27 maj 2026	Fillimi i konsultimeve publike	Teksti i draftit më në fund publikohet për shqyrtim publik dhe procesi zyrtar i konsultimit publik fillon për të mbledhur komentet përfundimtare.
8 qershor 2025	Fundi i konsultimeve publike	Konsultimet publike u zhvilluan gjatë një periudhe prej 13 ditësh, gjatë të cilave palët e interesuara dhe qytetarët patën mundësinë të paraqisnin komente, vëzhgime dhe shtesa në përmbajtjen e draftit të Strategjisë Kombëtare.
19 qershor 2026	Miratimi nga KSHPK-ja dhe prezantimi në Parlament	Strategjia u miratua zyrtarisht në një seancë të KSHPK-së dhe po atë ditë iu dorëzua zyrtarisht Parlamentit, me një vonesë tashmë të akumuluar prej gjashtë muajsh.
Fundi i qershorit 2026 (Aktuale)	Bllokim parlamentar	Dokumenti ende nuk është paraqitur për shqyrtim në organin përkatës parlamentar, gjë që e zgjat më tej zbatimin.

3. Gjetjet kryesore nga procesi i zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (2026-2030)

Një shqyrtim gjithëpërfshirës i rrugës që ka ndjekur Strategjia Kombëtare nga punëtorët fillestare deri në prapësinë parlamentare lejon një perceptim objektiv të të gjitha cilësive dhe anomalive të këtij procesi. Përvojat e 16 muajve të fundit ofrojnë një mësim të rëndësishëm se si institucionet shtetërore bashkëpunojnë me sektorin e shoqërisë civile dhe si i trajtojnë ato kapacitetet e tyre administrative. Ndërsa faza të caktuara demonstrojnë një shkallë të lartë përfshirjeje dhe përgatitjeje serioze analitike, hapat e fundit u përballën me dobësi serioze institucionale dhe afate të humbura që ndikojnë drejtpërdrejt në arritjen përfundimtare të vetë dokumentit.

Më poshtë është një përpunim i detajuar i praktikave pozitive që duhet të shërbejnë si model për të ardhmen, si dhe i mangësive sistematike që kërcënojnë suksesin e strategjisë së re.

3.1. Avantazhet e procesit

- **Respektimi i renditjes së hapave analitikë në përgatitje:** Një hap pozitiv në këtë proces është përpjekja e KSHPK-së për të krijuar një strukturë në përgatitje, në vend që t'i qaset shkrimit ad-hok të masave. Fakti që procesi u krijua në mënyrë të tillë që fillimisht u miratuan korniza të veçanta metodologjike dhe më pas u krye një vlerësim në terren i rreziqeve të korrupsionit, tregon një qëllim për të futur rregull në planifikimin strategjik. Pavarësisht debateve të mëtejshme të ekspertëve në lidhje me cilësinë dhe përmbajtjen e vetë metodologjive, është e rëndësishme të theksohet se Strategjia bazohet zyrtarisht në hapat analitike të kryera më parë,

të cilat penguan përcaktimin e prioriteteve kryesore të sektorit pa një procedurë të përshtatshme institucionale.

- **Modeli gjithëpërfshirës i konsultimeve horizontale:** Kufizimi i debateve kundër korrupsionit vetëm në qarqet e mbyllura qeveritare në të kaluarën ka rezultuar një dështim i plotë. Duke organizuar grupe fokusi kombëtare në qershor 2025, si dhe punëtori në nëntor dhe dhjetor të të njëjtit vit, KSHPK arriti të krijojë një dialog të drejtpërdrejtë me palë të shumta të interesuara, duke përfshirë praktikuesit dhe zbatuesit nga sektori publik, përfaqësuesit e shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit akademik. Ky model bëri të mundur “nxjerrjen” e problemeve nga praktika që shpesh mbeten të padukshme për tekstet e pastra ligjore dhe krijimin e masave dhe aktiviteteve të përshtatshme për nevojat e luftës kundër korrupsionit.
- **Hapja ndaj partneritetit me sektorin e shoqërisë civile:** Përfshirja e Platformës së organizatave të shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit në shtator 2025 tregoi se KSHPK e njeh shoqërinë civile si një aleat serioz. Fakti që kërkesat për optimizim strategjik u dëgjuan dhe që dokumenti të jetë më i shkurtër, më konciz dhe pa barrë të panevojshme administrative flet për një gatishmëri për të dëgjuar zërin e publikut ekspert në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëri e vërtetë në terren.

3.2. Dobësitë e sistemit dhe dështimet e procesit

- **Shkelje serioze e afateve dhe futje e papërgjegjshme në një boshllëk strategjik.**

Miratimi i një dokumenti kaq kyç duhet të jetë linear dhe i planifikuar në kohën e duhur. Fakti është se strategjia e mëparshme u përfundua në dhjetor 2025 dhe ajo e reja iu dërgua Parlamentit vetëm në qershor 2026. Kjo vonesë prej gjysmë viti nuk është vetëm një mbikëqyrje administrative, por ka krijuar një boshllëk strategjik të rrezikshëm në nivel kombëtar. Për muaj të tërë, institucionet shtetërore, vetëqeverisja vendore dhe organet gjyqësore kanë vepruar pa një plan strategjik aktiv kundër korrupsionit, gjë që e zvogëlon kohezionin institucional dhe i ngadalëson reformat në negociatat me BE-në.

- **Errësira e informacionit në fazën e konsolidimit të brendshëm.**

Edhe pse procesi në vitin 2025 u menaxhua me një nivel të lartë transparence, gjysma e parë e vitit 2026 solli një ndërprerje totale të komunikimit nga KSHPK-ja. Kaluan pothuajse gjashtë muaj midis finalizimit të punësitorive në dhjetor 2025 dhe publikimit zyrtar të dokumentit për shqyrtim publik në fund të majit 2026. Gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore, publiku nuk mori asnjë shpjegim logjik se pse vonesa ishte për shkak - qoftë për shkak të vështirësive të brendshme teknike, rezistencës nga disa ministri që nuk i pranuan masat, apo kapacitetit të vetë Komisionit. Aq më tepër që konsultimet publike u zhvilluan pa pasur publiku njohuri për rezultatin përfundimtar të tyre. Kjo heshtje informative hedh një hije mbi procesin përndryshe gjithëpërfshirës.

- **Procesi i njëanshëm i konsultimit dhe mungesa e një mekanizmi përgjigjeje.**

Përfshirja e vërtetë kërkon komunikim dypalësh. Edhe pse Platforma e shoqërisë civile për LKK dhe palët e tjera të interesuara u ftuan të jepnin komente, KSHPK nuk publikoi asnjë raport mbi rezultatin e konsultimeve publike pas përfundimit të procesit. Sektori i shoqërisë civile mbeti pa informacion se cilat nga propozimet e tyre u përfshinë, cilat u refuzuan dhe më e rëndësishmja, për çfarë arsyesh (ligjore, financiare ose administrative). Pa një shpjegim të tillë me shkrim, konsultimet publike rrezikojnë të shndërrohen në një formalitet për “e kontrolluar” në skenën ndërkombëtare.

- **Rreziku i humbjes së plotë të vitit të parë të zbatimit për shkak të bllokimit parlamentar**

Nëse Parlamenti nuk e miraton Strategjinë sa më shpejt të jetë e mundur, ekziston një rrezik serioz dhe real i humbjes së një viti të tërë kalendarik. Duke pasur parasysh që jemi tashmë në gjysmën e dytë të vitit 2026 dhe procedurat parlamentare, seancat dëgjimore të komisioneve dhe amendamentet e mundshme mund ta zvarrisin më tej procesin deri në vjeshtë ose dimër, institucionet praktikisht nuk do të kenë kohë as të fillojnë aktivitetet e planifikuara për këtë vit. Kjo do të krijojë një efekt “topi dëbore” ku detyrimet e pareaizuara nga viti 2026 do të përhapen dhe do ta mbingarkojnë vitin 2027.

- **Paradoksi i një fushëveprimi strategjik të shkurtuar dhe një shkurtimi de facto të afatit kohor**

Vonesa ngre pyetjen kyçe logjike dhe thelbësore nëse kjo do të jetë realisht një strategji pesëvjeçare. Në letër, dokumenti është hartuar dhe ndërtuar për të qenë i vlefshëm për një periudhë të caktuar nga janari 2026 deri në dhjetor 2030. Megjithatë, meqenëse fillimi zyrtar është shtyrë tashmë me më shumë se gjysmë viti dhe kufiri përfundimtar i aktiviteteve mbetet i pandryshuar, shteti në realitet do të marrë një strategji të shkurtuar katërvjeçare. Kjo krijon një boshllëk serioz operativ, pasi institucionet do të pritët të zbatojnë një fushëveprim pesëvjeçar të detyrimeve dhe reformave në një dritare kohore dukshëm të ngushtuar dhe të shkurtuar. Përveç kësaj, nuk duhet harruar se Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit thotë se po miratohet një Strategji pesëvjeçare dhe kjo ngre pyetjen nëse korniza ligjore është përmbushur.

4. Rekomandime për veprim

Gjetjet nga procesi i analizuar tregojnë qartë se cilësia e një strategjie varet jo vetëm nga përmbajtja e saj, por edhe nga disiplina institucionale në miratimin e saj. Vakumi serioz strategjik, mungesa e reagimeve pas konsultimeve publike dhe rreziku real i një shkurtimi de facto të afatit kohor pesëvjeçar të dokumentit, imponojnë nevojën për një përgjigje urgjente dhe të koordinuar nga të gjitha palët e interesuara. Për të parandaluar që Strategjia Kombëtare të bëhet një tjetër dokument formal pa një efekt të konsiderueshëm në terren, vendimmarrësit duhet të adresojnë menjëherë mangësitë sistematike dhe ligjore të fazës përgatitore.

Bazuar në sfidat e identifikuar, më poshtë përcaktohen rekomandime specifike për veprim të menjëhershëm, të ndara sipas rolit të palëve kryesore të interesuara në proces:

4.1. Për Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

- **Vënia urgjente e Strategjisë Kombëtare në procedurë parlamentare**

Legjislatura duhet të tregojë përgjegjësi politike dhe ta vendosë dokumentin në rendin e ditës të komisioneve përkatëse pa vonesë. Çdo vonesë e mëtejshme e thellon boshllëkun e dëmshëm strategjik dhe e shkurton më tej kohën për zbatimin e reformave.

- **Harmonizimi ligjor dhe procedural i afateve para votimit**

Parlamenti, në koordinim me KSHPK-në, duhet të rishikojë afatin kohor në Planin e veprimit para miratimit përfundimtar të Strategjisë Kombëtare. Për të përmbushur dispozitën ligjore të detyrueshme për një strategji pesëvjeçare, është e nevojshme të hiqen gradualisht afatet e zbatimit (për shembull, deri në mesin e vitit 2031), gjë që do të parandalojë pasigurinë ligjore dhe rrezikun e shkeljes formale të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

4.2. Për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK)

- **Futja e një mekanizmi të detyrueshëm reagimi**

Për të gjitha aktet strategjike dhe nënligjore të ardhshme, KSHPK-ja duhet të krijojë një praktikë të publikimit të një shqyrtimi zyrtar pas përfundimit të konsultimeve publike. Ky dokument duhet të deklarojë publikisht dhe në mënyrë të plotë

se cilat propozime nga palët e interesuara janë pranuar dhe cilat janë refuzuar, me justifikim të saktë ligjor ose logjistik për arsyet.

- **Transparenca institucionale në fazat e punës së brendshme**

KSHPK-ja duhet të braktisë modelin e “heshtjes së informacionit” gjatë konsolidimit të brendshëm të dokumenteve. Edhe kur bëhet fjalë për pastrimin e teksteve ose harmonizimet ndërinstitucionale që zgjasin me muaj, Komisioni është i detyruar të informojë në mënyrë proaktive publikun për statusin e procesit, në mënyrë që të mos lërë hapësirë për dyshime për presione të brendshme ose deficite institucionale.

- **Planifikimi proaktiv i cikleve strategjike të ardhshme**

Për dokumentet strategjike pasuese, aktivitetet përgatitore dhe vlerësimet në terren duhet të fillojnë të paktën 9 deri në 12 muaj para skadimit të strategjisë aktuale. Kjo do të sigurojë kohë të mjaftueshme që të gjithë filtrat të jenë në vend pa e lënë vendin në një boshllëk strategjik.

4.3. Udhëzime për veprimin e organizatave të shoqërisë civile

- **Përshtatja e monitorimit të pavarur me afatin kohor të shkurtuar**

Organizatat e shoqërisë civile që e monitorojnë zbatimin e politikave kundër korrupsionit duhet ta përshtasin fokusin e tyre të monitorimit me situatën e re. Megjithatë viti i parë i zbatimit është seriozisht i rrezikuar për shkak të vonesave administrative, monitorimi në periudhën e ardhshme duhet të masë konkretisht aftësinë e institucioneve për të kompensuar dhe transferuar detyrimet e parealizuar nga viti 2026 në vitin 2027, me qëllim parandalimin e një shembjeje të plotë të fazës fillestare të Strategjisë.

- **Vlerësim ad-hok i tekstit përfundimtar kundrejt propozimeve të parashtruara**

Në përgjigje të mungesës së një raporti zyrtar nga konsultimet publike nga KSHPK-ja, sektori i shoqërisë civile duhet nëpërmjet mjeteve të veta analitike, të krahasojë tekstin përfundimtar që do të miratohet nga Kuvendi i RMV-së me propozimet që u dorëzuan nga publiku i ekspertëve në maj/qershor 2026. Kjo do të lejojë një vlerësim të pavarur të masës në të cilën zëri i palëve të interesuara është përfshirë vërtet në mënyrë thelbësore në dokumentin përfundimtar.

- **Presion i vazhdueshëm publik duke regjistruar pasojat e vakumit strategjik**

Shoqëria civile duhet të dokumentojë dhe komentojë vazhdimisht publikisht çdo ditë shtesë të kaluar në një boshllëk strategjik. Nëpërmjet alarmeve publike dhe analizave të synuara të ngërçit, është e nevojshme të ruhet një nivel i lartë vigjilence publike dhe të gjendet përgjegjësi e qartë politike midis aktorëve shoqërorë për vonesën e këtij dokumenti kyç të reformës kombëtare.

